

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                   |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Dënimi i ish-krerëve të UÇK/ Reagon PDK: Aktgjykim i padrejtë dhe i papranueshëm, beteja për drejtësi vazhdon deri në fund                                                                                                        |
| ADRESA  | <a href="https://dosja.al/politike/denimi-i-ish-krereve-te-uk-reagon-pdkaktgjykim-i-padrejte-dhe-i-papranu-i514418">https://dosja.al/politike/denimi-i-ish-krereve-te-uk-reagon-pdkaktgjykim-i-padrejte-dhe-i-papranu-i514418</a> |
| BURIMI  | dosja.al                                                                                                                                                                                                                          |
| GJENDJA | edited                                                                                                                                                                                                                            |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 16 shtator 2026, 10:33:17 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 10:20:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                    |
|------------|--------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | e7e82baf7e868ef730f30526c26e9fb1c3e924e43e3e1a2c422e02d125d662d6   |
| TEKSTI     | f5708c37749dcdb39b3f8eeb8df30d73f1e467e468b95e8ba67b1ada3a8c165f   |
| PAMJA      | 63e3d2de3d53a483154220bf1cbfaa40cb66fd4cd69d1bad8b7600f16dafa0e0e6 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 41df12df45232642a2cf5a22131c06dd02df6c2db7cd9115cf824cea8e7d6fdf                                                                                                   |
| E MËPARSHMJA  | 7b60157b7040d83ff3ed6f4145bab2d708463da9a8b2269b07bcce16a9b321ed                                                                                                   |
| RRËNJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI      | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/41df12df45232642a2cf5a22131c06dd02df6c2db7cd9115cf824cea8e7d6fdf>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





LIVE UPDATES

39 MINUTA ME PARE

Haga dënoi Kosovën/ Tensione dhe përplasje jashtë Gjykatës Speciale, familjarët e ish-krerëve të UÇK-së: E papranueshme, do e apelojmë

4 ORE ME PARE

Gjykata Speciale ridënon Kosovën. Bie akuza për krime kundër njerëzimit, po dënimet jepen maksimale. Thaçi & Krasniqi 25 vite burg, 18 Veseli dhe 13 Selimi

15 ORE ME PARE

SYTË NGA HAGA/ Nesër shpallet vendimi për ish-krerët e UÇK-së, rrugët mbushen me flamuj e mbishkrime për Thaçin, Veselin, Krasniqin e Selimin: Shpallini të pafajshëm (PAMJET)

17 ORE ME PARE

108 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Edi Rama jep dorëheqjen

Politike

# Dënimi i ish-krerëve të UÇK/ Reagon PDK: Aktgjykim i padrejtë dhe i papranueshëm, beteja për drejtësi vazhdon deri në fund

Sipas tyre, vendimi i sotëm është një goditje e rëndë për luftën e UÇK-së, lirinë, pavarësinë dhe shtetin e Kosovës.



16 Shtator 2026, 12:20  
Nga E.d



Foto ilustruese

**KOSOVA-** Partia Demokratike e Kosovës ka reaguar pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë ku trupa gjykuese dënoi në total me 81 vite burg katër ish-krerët e UÇK-së, Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin. Përmes një deklarate të publikuar në rjetet sociale, PDK shprehet se aktgjykimi ishte i padrejtë dhe i papranueshëm, por beteja për drejtësi do të vazhdojë deri në fund.

PDK e cilëson aktgjykimin si një padrejtësi e madhe, sepse mbështetet në pretendime e materiale të ushqyera ndër vite nga aparati shtetëror dhe propaganda e Serbisë për ta kriminalizuar luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sipas tyre, vendimi i sotëm është një goditje e rëndë për luftën e UÇK-së, lirinë, pavarësinë dhe shtetin e Kosovës.

Në fund, PDK shprehet se ajo do të qëndrojë përherë në mbrojtje të së vërtetës historike, të dinjitetit të luftës çlirimtare dhe të atyre që morën mbi vete barrën e lirisë së Kosovës. Kjo duke shtuar se, ky aktgjykim nuk është fjala e fundit.

## Reagimi i plotë

Partia Demokratike e Kosovës shpreh indinjatën, zhgënjimin dhe kundërshtimin e saj për aktgjykimin e sotëm të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Sot në Hagë u godit rëndë e drejta e popullit tonë që luftoi për liri, mbijetesë dhe çlirim nga regjimi shtetëror serb që vrau, dëboi dhe terrorizoi shqiptarët e Kosovës. Për ne, ky aktgjykim është një padrejtësi e madhe, sepse mbështetet në pretendime e materiale që i konsiderojmë të fabrikua dhe të ushqyera ndër vite nga aparati shtetëror dhe propaganda e Serbisë për ta kriminalizuar luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

## editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet  
kërkuar tek revolta e  
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

## Në vëmendje

POLITIKE 16 SHTATOR 2026, 12:46

**DOKUMENTI/ Publikohet vendimi i plotë i dënimit të ish-krerëve të UÇK-së**

AKTUALITET 16 SHTATOR 2026, 12:40

**"Vendimi i Gjykatës Speciale në Hagë u prit në lot nga qytetarët" / Reuters: Vendimi u ndoq nga afër edhe Serbi**

Ky aktgjykim mund të jetë shkruar në Hagë. Por historia e Kosovës është shkruar këtu, me sakrificë, gjak dhe luftë për liri. Dhe ajo nuk rishkruhet sot.

Historia jonë është shkruar nga populli ynë që luftoi për mbijetesë, nga mijëra dëshmorë e martirë, nga qindra mijëra qytetarë të dëbuar prej shtëpive të tyre dhe nga një aleancë historike me botën demokratike që, në vitin 1999, i dha fund represionit dhe spastrimit etnik të regjimit serb në Kosovë. Agresori ishte Serbia. Viktima ishte Kosova. Dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte përgjigjja e popullit tonë që kërkonte të jetonte i lirë. Këtë të vërtetë nuk mund ta ndryshojë asnjë aktgjykim. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi nuk shkuan në Hagë duke ikur nga drejtësia. Ata iu përgjigjën asaj vullnetarisht, me besimin se e vërteta do të triumfojë.

Prandaj, vendimi i sotëm është një goditje e rëndë për luftën e UÇK-së, lirinë, pavarësinë dhe shtetin e Kosovës. Sot, qytetarët e Kosovës ndihen të lënduar dhe të zhgënjyer nga ky aktgjykim i padrejtë. PDK do ta kundërshtojë këtë aktgjykim me argumente, me të gjitha mjetet demokratike dhe në çdo forum ku duhet mbrojtur e vërteta për luftën e Kosovës. Për ne, lufta e UÇK-së ishte e drejtë, mbrojtëse dhe çlirimtare. Dhe njerëzit që udhëhoqën luftën dhe proceset politike që sollën lirinë dhe shtetin e Kosovës nuk mund të fshihen nga historia me një vendim gjyqësor. Sot është një ditë e rëndë për Kosovën. Por sot nuk përfundon as historia, as beteja për të vërtetën.

Partia Demokratike e Kosovës do të qëndrojë përherë në mbrojtje të së vërtetës historike, të dinjitetit të luftës çlirimtare dhe të atyre që morën mbi vete barrën e lirisë së Kosovës. Ky aktgjykim nuk është fjala e fundit. Ne për drejtësinë do të luftojmë deri në fund dhe për të vërtetën nuk do të heshtim kurrë. Heronjtë tanë të luftës dhe paqes nuk do t'i lëmë kurrë vetëm. Beteja vazhdon, me ta dhe për ta, deri në lirinë e tyre./Dosja.al

pdk    haga    vendime

## Sondazh

Poll

AKTUALITET 16 SHTATOR 2026, 12:09

“Nuk do të na thyejë” / Vajza e Jakup Krasniqi reagon pas dënimit me 25 vjet: Padrejtësia më e madhe e këtij shekulli

## më të klikuarat

- 

SKANDAL/ Deputetja Zegjine Çausi ishte në djeni se daja i saj kishte marrë peng dhe përdhunuar të renë. Viktima: Erdhi në shtëpi, tha se do na fus në telashe
- Rishfaqet “diMAL”, pas mishit të infektuar, drogë në kontejner
- “Paga bruto e një magjistari”/ Gafat e njëpasnjëshme të deputetes socialiste: Mos e bëni kaq të madhe, është laps
- Gjykata e Lartë e la në burg Erion Veliajn/ Rama: Sërish Tirana pa kokë, askush nuk do t’ia dijë për koston e kryeqytetit

## insights

- Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë
- Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen
- Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?
- Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e “shkarkoi” sot Edi Ramen?

## Moti

Powered by  tomorrow.

# snpresat, mbetet apen

Hysni Gucati HAGË- Kryetari i OVL-UÇK-së, Hysni Gucati, e ka dënuar ashpër aktgjykimin ndaj ish-krerëve të UÇK-...

"E papranueshme"/ Bardhi pas vendimit të Hagës: Askush nuk mund ta bëjë pis luftën e drejtë për lirinë e Kosovës

Politike  
16 Shtator 2026, 12:12

"Jo në emrin tim"/ Haradinaj: Dënimi për katërshen i padrejtë

Politike  
16 Shtator 2026, 11:57

Konjufca: Vendim i padrejtë dhe i pamerituar

Politike  
16 Shtator 2026, 11:45



Rexhep Selimi shpallet fajtor në Hagë, dënohet me 13 vite burg

Politike  
16 Shtator 2026, 11:42

Politike  
16 Shtator 2026, 11:33

## Haga dha dënimet për ish-krerët e UÇK-së, reagon Rama: Marre!

Edi Rama TIRANA- Kryeministri i vendit, Edi Rama ka reaguar pasi Gjykata Speciale në Hagë dha dënimet për katër ish-krerët e...



Kadri Veseli shpallet fajtor në Hagë, dënohet me 18 vite burg

Politike  
16 Shtator 2020, 11:40



## Jakup Krasniqi shpallet fajtor në Hagë, dënohet me 25 vite burg

Politike  
16 Shtator 2020, 11:36



## Hashim Thaçi shpallet fajtor në Hagë, dënohet me 25 vite burg

Politike  
16 Shtator 2020, 11:32

## Trupi gjykues: Krasniqi ishte anëtar kyç në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal

Politike  
16 Shtator 2020, 11:31

MË SHUMË



Tensione jashtë Gjykatës Speciale në Hagë, shqiptarët përplasen me policinë, nis shoqërimi i tyre

Pas vendimeve të Hagës, nisin protestat masive në Prishtinë: Marre!

"Jo në emrin tim"/ Haradinaj: Dënimi për katërshen i padrejtë

Rexhep Selimi shpallet fajtor në Hagë, dënohet me 13 vite burg

Tensione jashtë Gjykatës Speciale në Hagë, shqiptarët përplasen me policinë, nis shoqërimi i tyre

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të

AKTUALITET  
POLITIKE  
EKONOMI

Drejtore: Enton Abilekaj  
Kryeredaktor: Izmir Akulli  
Gazetarë:

Interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444  
Email: [email protected]



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MUNDËSHKAR NGA  Mediadesk

**BOTA**

**SPORT**

**ART&ARGËTIM**

**INSIGHTS**

**EDITORIAL**

Esmeralda Doçi  
Emanuela Dida  
Elisa Karaj  
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.